REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7371 Nr. i faq/Br.str/No.pg 40
Data/Datum/Date 18/05/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
*Republika Kosova – Republic of Kosovo*

**Komuna e Rahovecit**
*Opština Orahovac – Municipality of Rahovec*

## KRYETARI I KOMUNËS
*Presednik Opštine – Municipal Mayor*

---

### LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

### NGA DATA 11.05.2026 DERI MË 15.05.2026

| NR. | EMRI I VENDIMIT | NR. I PROTOKOLLIT |
|---|---|---|
| 1. | Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : *"Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit"* | NRP-02-7355-2026 |
| 2. | Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: *"Rrethimi i oborreve të shkollave"* | NRP-02-7356-2026 |
| 3. | Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: *"Furnizimi për luftimin e insektit cikadia e hardhisë së rrushit"* | NRP-02-7357-2026 |
| 4. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: *"Ndërtimi i serrave me participim"*. | NRP-02-7358-2026 |
| 5. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: *"Furnizimi me pleh artificial"*. | NRP-02-7359-2026 |
| 6. | Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes). | NRP-02-7360-2026 |
| 7. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: *"Furnizimi me paisje të teknologjisë informative"*. | NRP-02-7363-2026 |
| 8. | Vendim për qasje në dokumente publike. | NRP-02-7365-2026 |
| 9. | Vendim për caktimin e komisionit për ndryshim plotësimin e vendimit për caktimin e komisionit diciplinor nënpunësit civi. | NRP-02-7369-2026 |
| 10. | Vendim për caktimin e jurisë profesionale për vlerësimin e punimeve për dizajnimin e logos dhe brendimin e turizimit në Komunën e Rahovecit. | NRP-02-7370-2026 |
| 11. | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7355 Nr. i faq/Br.str/No.pg 38
Data/Datum/Date 12 /05/ 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit"**

1. Bekim Krasniqi, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Ofrimi i shërbimeve të sigurimit fizik të objekteve të Komunës së Rahovecit".

2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:

   3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);

   3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;

   3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 14.5.2026.

5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Bekim Krasniqi,***
- ***Drejtoria për Administratë,***
- ***Njësia e Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 736 Nr. i faq/Br.str/No.pg 38
Data/Datum/Date 12 / 05 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin **" Rrethimi i oborreve të shkollave „** me Nr. Prokurimi:**623-26-2494-5-2-1 ,** Numër i brendshëm **: 623-26-013-5-2-1 të datës 12.05.2026**, në përbërje prej:

    **1.1** Jetmir Ukaj Kryesues
    **1.2** Vjollca Berisha , Anëtare
    **1.3** Egzon Thaqi , Anëtare

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit për projektin **"Rrethimi i oborreve të shkollave ''**
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

***U dërgohet :***

1. ***Anëtarëve të komisionit***
2. ***Zyrës së Prokurimit dhe***
3. ***Arkivit***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / KRYETARI I KOMUNËS / PREDSENIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR / RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7357 Nr. i faq/Br.str/No.pg 38
Data/Datum/Date 12/05/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të prokurimit publik, nenit 37 i Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin **" Furnizimi me preparatet për luftimin e insektit cikadia e hardhisë së rrushit „** me Nr. Prokurimi:**623-26-2966-1-2-1** , Numër i brendshëm **: 623-26-017-1-2-1 të datës 12.05.2026**, në përbërje prej:

   **1.1** Egzon Thaqi , Kryesues
   **1.2** Kosovare Gashi , Anëtare
   **1.3** Dhurata Rustemi, Anëtare

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të tenderit për projektin **"Furnizimi me preparatet për luftimin e insektit cikadia e hardhisë së rrushit ''**

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet :*
1. *Anëtarëve të komisionit*
2. *Zyrës së Prokurimit dhe*
3. *Arkivit*

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7358 Nr. i faq/Br.str/No.pg 38
Data/Datum/Date 12 / 05/ 26

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i serrave me participim 80% - 20%", me Nr. prokurimi: 623-26-2552-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-26-016-5-2-1 të datës: 12.5.2026, në këtë përbërje:

   1.1. Jetmir Ukaj, kryesues
   1.2. Kosovare Gashi, anëtare
   1.3. Enise Dina, anëtare

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i serrave me participim 80% - 20%", me Nr. prokurimi: 623-26-2552-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-26-016-5-2-1 të datës: 12.5.2026.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7359 Nr. i faq/Br.str/No.pg 38
Datum/Date 12 / 05 / 26

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M
### Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me pleh artificial", me Nr. prokurimi: 623-26-2997-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-26-019-1-2-1 të datës: 12.5.2026, në këtë përbërje:

   1.1. Egzon Thaqi, kryesues
   1.2. Kosovare Gashi, anëtare
   1.3. Bekim Krasniqi, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me pleh artificial", me Nr. prokurimi: 623-26-2997-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-26-019-1-2-1 të datës: 12.5.2026.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Rahovec/Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kabineti i Kryetarit të Komunës/Kabinet Presednika Opštine/Municipal Mayor Cabinet
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7360 Nr. i faq/Br.str/No.pg 38
Data/Datum/Date 12 05 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

---

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-00/15470/26 dt. 12.05.2026 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *A r s y e t i m*

**Znj**[redacted] nga Rahoveci me datë 12.05.2026 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 02.05.2026 ka lindur **Djal** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për **znj.**[redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Znj**[redacted] **nga Rahoveci,***
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality of Rahovec
Kryetari i Komunës / Presednik Opštine
Rahovec / Orahovac

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7363 Nr. i faq/Br.str/No.pg 39
Data/Datum/Date 13/05/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative në bazë të kontratës së AQP-së", me nr. prokurimi: 623-26-3080-5-5-8 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-020-1-2-1, të datës 13.5.2026, në këtë përbërje:

    1.1. Bekim Krasniqi, kryesues,
    1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
    1.3. Enise Dina, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative në bazë të kontratës së AQP-së", me nr. prokurimi: 623-26-3080-5-5-8 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-020-1-2-1, të datës 13.5.2026.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7365 Nr. i faq/Br.str/No.pg 39
Data/Datum/Date 14/05/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016")*, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/2019")*, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
## Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/7351, e datës 12.5.2026 për qasje në dokumente publike nga Leorenta Alija nga Democracy Plus dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike lidhur me anulimin e procedurës së tenderit për projektin "Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Opterushë – Faza 2" dhe atë në dokumentacionin si në vijim:
   1.1. A ka pasur koordinim apo komunikim zyrtar nga ana e MINTI-in me Komunën e Rahovecit për konfirmimin e vazhdimit të zotimit financiar dhe bashkëfinancimit të projektit nga ana e komunës para anulimit të tenderit;
   1.2. A është kërkuar vazhdimi/ripërtëritja e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe cilat kanë qenë veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna? Kjo për shkak që në memorandumin e bashkëpunimin nuk paraqitet ndonjë datë skadence;
   1.3. A ka ende gatishmëri dhe mjete të planifikuara nga Komuna e Rahovecit për bashkëfinancimin e këtij projekti në rast të rishpalljes së tenderit.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### *Arsyetim*

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/7351, e datës 12.5.2026 për qasje në dokumente publike nga Leorenta Alija nga Democracy Plus.

Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtës i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike lidhur me anulimin e procedurës së tenderit për projektin "Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial në Opterushë – Faza 2" dhe atë në dokumentacionin si në vijim:

- Nëse ka pasur koordinim apo komunikim zyrtar nga ana e MINTI-in me Komunën e Rahovecit për konfirmimin e vazhdimit të zotimit financiar dhe bashkëfinancimit të projektit nga ana e komunës para anulimit të tenderit;
- Nëse është kërkuar vazhdimi/ripërtëritja e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe cilat kanë qenë veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna? Kjo për shkak që në memorandumin e bashkëpunimin nuk paraqitet ndonjë datë skadence;
- Nëse ka ende gatishmëri dhe mjete të planifikuara nga Komuna e Rahovecit për bashkëfinancimin e këtij projekti në rast të rishpalljes së tenderit.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,***
- ***Leorenta Alija nga Democracy Plus, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***KomunaRahovec***
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7369 Nr. i faq/Br.str/No.pg 39
Data/Datum/Date 15/05/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenin 60 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L- 197 për Zyrtar Publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Mr. 21/2023), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2, nenit 11 paragrafi 10 pika 2 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për disiplinën e nëpunësve civil e 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016 nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

**V E N D I M**
**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr. prot.7199, të datës 08.4. 2026, për caktimin e komisionit disiplinor për nëpunësit civil**

1. Me këtë vendim plotësohet ndryshohet pika 1, 1.2 e vendimi me nr. prot. 7199, të datës 08.4.2026, për caktimin e komisionit disiplinor për nëpunësit e shërbimit civil.

2. Pika 1, paragrafi 1.2 i vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:
   1.2. Sevdije Dina, anëtare.

3. Pikat e tjera të vendimit bazik me nr. prot. 7199, të datës 08.4.2026, mbesin të pandryshuara.

4. Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

**Arsyetim**

Me vendimin nr. prot. 7199, të datës 08.04.2026, është caktuar komisioni disiplinor për nëpunësit civil. Duke marrë parasysh se Agron Thaqi, i cili me vendim bazik ishte caktuar anëtarë, nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni, është e domosdoshme zëvendësimi i tij dhe caktimi i Sevdije Dina anëtare nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Andaj nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Sevdije Dina,***
- ***Fiknete Kasapi Iska,***
- ***Njësisë së Personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7370 Nr. i faq/Br.str/No.pg 39
Data/Datum/Date 15/05/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")* dhe nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
**Për caktimin e jurisë profesionale për vlerësimin e punimeve për dizajnimin e logos dhe brendimin e turizmit në Komunën e Rahovecit**

1. **Caktohet** juria profesionale për vlerësimin e punimeve për dizajnimin e logos dhe brendimin e turizmit në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:

   1.1. Fehmi Hoxha, kryesues
   1.2. Selami Haxhijaha, anëtar
   1.3. Bedri Hoti, anëtar
   1.4. Ruzhdi Hoxha, anëtar
   1.5. Naim Kafexhiu, anëtar

2. Juria profesionale ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e punimeve për dizajnimin e logos dhe brendimin e turizmit në Komunën e Rahovecit.

3. Obligohet juria profesionale që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Anëtarët e jurisë do të fillojnë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Juria e caktuar për punën e saj do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e jurisë,***
- ***Sektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**